

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. 5539/ prot.
14

Pogradec, më 12 . 12 2022

VENDIM
Nr. 136, DATË 09/12/2022

PËR

*MIRATIMIN E MARRËVESHJES MIDIS BASHKISË POGRADEC DHE SUBJEKTEVE TË CILAT DO
TË TREGËTOJNË DHE MIRËMBAJNË PIKAT E SHËRBIMIT EX-MARKET PËRGJATË RRUGËS
NACIONALE LIN-POGRADEC*

Bazuar ne nenin 9 pika 1.1 germa a, b, neni 22/2, neni 22, 25, 26 dhe 28, neni 54 germa e te ligjit 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore", kreut IX, nenet 901 e në vazhdim të Kodit Civil,

VENDOSI

1. Te miratoje marreveshjen bashkangjitur, "**Për mirëmbajtjen dhe funksionimin e ex-marketeve përgjatë rrugës nacionale Lin Pogradec**", të cilat do shërbejnë si pika informi turistik, dhe tregëtimi të produkteve të banorëve të zonës.
2. Autorizohet dhe ngarkohet Kryetari i Bashkisë, për firmosjen e marrëveshjes dhe Shoqëria "Pogradeci Invest" shpk për ndjekjen dhe zbatimin e ketij vendimi:
3. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

KRYETAR I KËSHILLIT
Sotiraq MANGËRI





BASHKIA POGRADEC

Subjekti _____

Nr. _____ Prot

Pogradec, më. ____ . ____ . 2022

**MARRËVESHJE PËR FUNKSIONIMIN E EX-MARKETEVE NË RRUGËN NACIONALE
LIN-POGRADEC.**

E lidhur sot me datën ____ / ____ / 2022, mes paleve:

BASHKIA POGRADEC me adrese Rr. Rreshit Çollaku, 1gj. Nr. 3, Pogradec, perfaqesuar nga kryetari i Bashkise Pogradec, z. Ilir XHAKOLLI , qe me poshte do te cilësohet "Huadhënës"

DHE

Subjekti _____ atesia _____, amesia _____, shtetas Shqiptar, lindur ne _____, dhe banues ne _____, me adrese _____, lindur me ____ / ____ / ____ , gjendja civile " _____ ", madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me Letemjofitim ID nr. _____ dhe nr. personal _____, I cili më poshtë do të cilësohet si "Huamarrës"

Baza Ligjore:

- ligj nr.7850, date 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar kreu IX, neni 901 dhe në vazhdim
- ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar.
- VKB nr. ____ dt. _____ " **Për miratimin e marrëveshjes midis Bashkisë Pogradec dhe subjekteve të cilat do të tregëtojnë dhe mirëmbajnë pikat e shërbimit Ex-market përgjatë rrugës nacionale Lin-Pogradec** "

Bashkia Pogradec, me miratimin e Keshillit Bashkiak Pogradec me ane te vendimit nr. _____, dt. ____ . ____ . ____ me emërtim " _____ "

Njesia Administrative Udënisht, Bashkia Pogradec **për pikën e shërbimit EX Market 1** sipërfaqe totale _____ m², mbështetur ne marrëveshjen midis Bashkisë Pogradec dhe FSHZH-së ku është përcaktuar ndërtimi I 3 (tre) ex-marketeve që do shërbejnë si pika Info, Wiew Point dhe pika tregëtimi të produkteve të zonës për vizitorët dhe frekuentuesit e bregut të liqenit bazuar ne nenet 901-912 te Kodit Civil, si dhe kerkeses se subjektit " _____ palet bien dakord te hartojne kete kontrate, me kushtet si me poshte:





Neni 1 Objekti i kontrates

- 1.1. Objekti i kesaj kontrate eshte dhënia me huapërdorim e pasurise shteterore: "Pika e shërbimit Ex-Market 1", ne pronesi te Bashkise Pogradec sipas dokumentit të marrjes në dorëzim, për ta mbajtur në funksionim si *pikë infomacioni turistik dhe pika tregëtimi për prodhimet e banorëve të zonës dhe produkteve turistike*.

Neni 2 Qellimi i perdorimit

- 2.1. Qellimi i kesaj kontrate është dhënia në mirëmbajtje dhe përdorim te përkohshëm i strukturës te percaktuar ne nenin 1, per vënien dhe mabjtjen në funksionim si pikë informacioni turistik, pika tregëtimi për prodhimet e banorëve të zonës dhe produkteve turistike". Shprehjet e mësipërme kanë kuptim si më poshtë:
- 2.1.1. Me pikë informacioni turistik kuptohet që subjekti në ex-market është I detyruar të japë informacion për gjithë vizitorët dhe të interesuarit për:
- 2.1.1.1. Pikat e vizitueshme ne Bashkinë Pogradec dhe aksesimin e tyre.
- 2.1.1.2. Informacion mbi infrastrukturën turistike,
- 2.1.1.3. Promovimin e vlerave etj...
- Për sa më sipër subjektet do mbështeten nga Specialistet e Turizmit me material promovuese dhe informacione.
- 2.1.2. Me pikë të tregëtimit të prodhimeve të banorëve të zonës kuptohet cdo product bujqësor, blektoral por dhe artizanal (punime dore etj), të prodhuara nga banorët e zonës.
- 2.1.3. Tregëtimi I prodhimeve të zonës mund të bëhet nga vetë banorët dhe huamarrësi është I detyruar ti lejojë ose duke mbledhur nga huamarrësi prodhime të banorëve të zonës dhe ti tregëtojë vetë.
- 2.1.4. Produkte turistike kuptohen, souvenirë turistike, oferta te hoteleve dhe restoranteve etj.
- 2.2. Objekti I cili do funksionojë ka të dhënat; pika e shërbimit Ex-Market 1", Njesia Administrative Udënisht, Bashkia Pogradec me siperfaqe totale _____ m2, sipas kerkeses se Huamarrësit dhe plan biznesit bashkelidhur kesaj kontrate .

Neni 3 Kohezgjatja

Kjo kontrate eshte e vlefshme per 4 (katër) vite dhe hyn ne fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

Neni 4

Te drejtat dhe detyrimet e Huadhënësit

- 4.1 "Huadhënësi", Bashkia Pogradec si njësi qe ka ne administrim pasurine shteterore, dorezon brenda nje muaji nga hyrja ne fuqi e kesaj kontrate, pronen e percaktuar ne nenin 1 te saj, te lire per t'u shfrytezuar per qellimin e kesaj kontrate. Ne momentin e dorezimit do te hartohet procesverbali i dorezimit te objektit qe jepet me qira i shoqeruar me foto, i cili eshte pjese perberese e kontrates.
- 4.2 "Huadhënësi" ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohe per respektimin e kushteve te kesaj kontrate nga ana e "Huamarrësit".
- 4.3 "Huadhënësi" ka te drejte qe, ne çdo kohe gjate kohezgjatjes se kontrates, nepermjet njesise monitoruese te kontrates, te monitoroje kontraten per verifikimin e zbatimit te kushteve te percaktuara ne te.
- 4.4 "Huadhënësi" eshte i detyruar te garantoje "Huamarrësin" per gezimin e qete te sendit, objekt te kesaj kontrate ndaj te treteve, te cilet mund te ngrene pretendime per te drejten e tyre


**BASHKIA POGRADEC**

mbi kete prone.

- 4.5 "Huadhënësi" ka te drejte te kerkoje zgjidhjen e kontrates kur Huamarrësi shkel detyrimet e marra persiper, duke njoftuar kete te fundit 30 dite përpara me shkrim.
- 4.6 "Huadhënësi" nuk eshte i detyruar te garantoje Huamarrësin nga shqetesimet e te treteve qe nuk pretendojne te kene te drejta mbi pronen.

Neni 5**Te drejtat dhe detyrimet e huamarrësit**

- 5.1 "Huamarrësi" ka te drejte qe, sipas legjislacionit ne fuqi, te perdore e te gezoje pronen e marre me huamarrje dhe permiresimet e bera ne te, per gjithë kohen qe eshte ne fuqi kjo kontrate.
- 5.2 "Huamarrësi" ka per detyre qe te perdore sendin, objekt te kesaj kontrate, per qellimin e parashikuar ne nenin 2, ne perputhje me detyrimet ligjore qe rrjedhin nga legjislacioni shqiptar.
- 5.3 "Huamarrësi" detyrohet qe, ne pasurine e marre me huamarrje, te realizoje aktivitetin sipas nenit 2 te kesaj kontrates.
- 5.4 "Huamarrësi" ka të drejtë të tregëtojë edhe produkte apo shërbime të tjera në ambient por pa penguar apo cënuar tregëtimin dhe shërbimet primare të përcaktuara në nenin 2 të kësaj marrëveshjeje.
- 5.5 "Huamarrësi" është I detyruar ti lejojë banorët e zonës të tregëtojnë prodhimet e tyre në kushte të përshtatshme si dhe të sigurojë vetë prodhime të zonës për të pasur gjithnjë për tregëtim.
- 5.6 "Huamarrësi" detyrohet te shfrytëzoje dhe te mirembaje objektin e kontrates.
- 5.7 "Huamarrësi" është I detyruar të mirëmbajë sheshqëndrimin, stolat, mobilimin urban dhe gjelbërimin në afërsi të pikësh ex-market për të siguruar akses të lirë për gjithë vizitorët që ndalojnë në këto shesh pushime.
- 5.8 "Huamarrësi" do të ekspozojë në vënd të dukshëm, logo, reklama, të cilat promovojnë qëllimin e pikave ex-market të përcaktuara në nenin 2.
- 5.9 "Huamarrësi" detyrohet te perballoje me shpenzimet e tij, detyrimet qe lidhen me demet e shkaktuara eventualisht paleve te treta.
- 5.10 "Qiramarrësi" është I detyruar të lidhë kontrata me furnitorët e shërbimeve për utilitetet e nevojshme për zhvillimin e aktivitetit (furnizim me energji elektrike dhe ujë sipas nevojës), në emër të tij duke përjashtuar "Huadhënësin" nga detyrimet mbi këta furnizues.
- 5.11 "Huamarrësi", ne funksion te qellimit sipas nenit 2 dhe zhvillimit te aktivitetit, ne territorin objekt i kesaj kontrate, detyrohet të njoftojë "Huadhënësin" për çdo ndërhyrje në strukturën e objektit dhe të marrë miratimin e tij.
- 5.12 "Huamarrësi" detyrohet qe ne momentin e perfundimit te kesaj kontrate te dorezoje pronen te pademtuar.
- 5.13 "Huamarrësi", ne perfundim te kesaj kontrate, ka te drejte te heqe permiresimet e ndashme nga prona, por pa e demtuar ate. "Huadhënësi" nuk ben kompensimin financiar te investimeve ne pasuri te paluajtshme te kryera nga "Huamarrësi".
- 5.14 Ne ngarkim te "Huamarrësit" jane te gjitha tatimet dhe detyrimet qe rendojne mbi pronen e dhene në përdorim.
- 5.15 "Huamarrësit" nuk i lejohet, qe pronen e dhene përdorim ta jape në cfarëdolloj mënyre në përdorim ose t'ia kaloje kontraten nje personi tjetër.
- 5.16 "Huamarrësi", ne funksion te qellimit dhe zhvillimit te aktivitetit sipas nenit 2 te kesaj kontrate, ne territorin objekt i kesaj kontrate, ne realizimin e treguesve te mare persiper, qe te pajiset me lejet ose autorizimet perkatese nga organet kompetente te parashikuara nga legjislacioni shqiptar.
- 5.17 "Huamarrësi" ne asnje rast nuk mund ta rendoje me barre, pronen objekt kontrate.

Neni 6**Zgjidhja e kontrates**

Republika e Shqipërisë
Bashkia e Pogradecit

**BASHKIA POGRADEC**

- 6.1. Kontrata zgjidhet me mbarimin e afatit te percaktuar ne piken 3 te kesaj kontrate.
- 6.2. Kontrata mund te zgjidhet para afatit:
- ne marreveshje midis paleve;
 - kur prona humbet teresisht ose demtohet per shkak te nje force madhore;
 - kur "huamarrësi" shkel detyrimet e marra përsipër sipas neneve 5 të kësaj kontrate.
 - kur prona nevojitet per interes publik;
 - kur prona kalon ne procedure privatizimi.
- 6.3. Kontrata pushon automatikisht se vepruari kur Huamarrësi është njoftuar rregullisht sipas pikës 4.5 të kësaj kontrate. Huamarrësi detyrohet te dorezoje objektin, 15 dite pas marrjes se njoftimit me shkrim te "Huadhënësit" per zgjidhjen e kontrates në rast të mosdorëzimit, objekti merret nga ana e huadhënësit edhe pa praninë e huamarrësit. Në këtë rast huadhënësi nuk mban përgjegjësi për pretendimet e huamarrësit mbi sende të lëna në object.

Neni 7**Pergjegjesite e paleve**


- 7.1. Palet pergjigjen per mosrespektimin e kushteve te kesaj kontrate.
- 7.2. Me "force madhore" do te kuptohet nje ngjarje qe eshte jashte kontrollit te paleve, si: termetet, permbytjet, lufta. Ne keto raste palet jane te detyruara te njoftojne njera-tjetren me shkrim. Koha e parashikuar per plotesimin e detyrimeve do te zgjatet per aq kohe sa do te vazhdojne keto rrethana.
- 7.3. "Huamarrësi" perjashtohet nga detyrimet per kohen e vazhdimit te forces madhore dhe mos kryerjes se aktivitetit per kete shkak. Kjo periudhe do te percaktohet me marreveshje midis paleve.

Neni 8**Dispozita te fundit**

- 8.1. Per gjithçka qe nuk eshte shprehur posaçerisht ne kete kontrate, palet do t'u referohen dispozitave te Kodit Civil ne fuqi.
- 8.2. Kesaj kontrate I bashkangjitet procesverbali i marrjes ne dorezimi te objektit, sipas kontrates.
- 8.3. Mosmarreveshjet qe mund te lindin mes paleve gjate zbatimit te kesaj kontrate do te zgjidhen me mirekuptim dhe ne rast se kjo eshte e pamundur, palet kane te drejte t'i drejtohen Gjykates se Rrethit Gjyqësor Pogradec.
- 8.4. Ne çdo rast te kalimit te mosmarreveshjeve, te lindura mes paleve ne juridiksion gjyqësor, autorizohet njesia administruese dhe monitoruese e kontrates per ndjekjen e procedures gjyqësore.
- 8.5. Kjo kontrate huadhënie eshte e vlefshme deri ne çastin, qe prona publike e dhene me qira privatizohet sipas akteve ligjore ne fuqi.

Neni 9

- 9.1. Kjo kontrate eshte formuluar ne 2 (dy) kopje origjinale, nga një për secilën palë. Pasi iu lexua paleve, u kuptua, u pranua prej tyre, si dhe u nenshkrua me vullnetin e tyre te plote e te lire.



Page 5 nga 6



**BASHKIA POGRADEC
QIRADHENES**

Bashkia Pogradec

Illir XHAKOLLI

Subjekti _____

QIRAMARRËS

Subjekti (_____)

(_____)

